S T A T U T

I

SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR " A L B E C O R P " E.B.O.

Ortaket e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar :

1 - Clement Israel — Nr.pasaportes 167278 A
datelindja 18.06.1939
vendlindja : Zaire , AFRIKE
vendbanimi : 105 AV.FRANKLIN , ROOSEVELT 1050 , BRUXELLES ,BELGIQUE

2 - David Fernandes — Nr.pasaportes 5366762
datelindja 02.02.1943
vendlindja Zaire AFRIKE
vendbanimi : 43 AV. ITALIE BRUXELLES 1050, BELGIQUE

3 - Daniel Israel — Nr.pasaportes 663720 I
datelindja 18.02.1969
vendlindja Zaire AFRIKE
vendbanimi : 105 AV FRANKLIN ROOSEVELT 1050 , BRUXELLES BELGIQUE

4 - Irfan Hysenbelliu — Nr.pasaportes 0026848
datelindja 08.04.1959
vendlindja Skrapar
vendbanimi : Rr.Sami Frasheri,Pallati 13 Ap16 Tirane, SHQIPERI

vee kontrates per themelimin e shoqerise ,sot ne daten , nenshkruan ne Tirane edhe statutin e saj qe eshte pjese perberese e kontrates se themelimit me permbajtje si vijon :

K A P I T U L L I I

EMRI SELIA DHE KOHEZGJATJA E SHOQERISE

N E N I 1

Shoqeria emertohet " ALBECORP " E.B.O. dhe eshte shoqeri me pergjegjesi te kufizuar ( Sh.p.k.)

NENI 2

Shoqeria e ka seline e saj ne Tirane me kete adrese : Rrug. S. Frashri Pall. 13 Ap. 16 . Selia e shoqerise mund te ndryshohet me vendim te Asamblese se Ortakeve . Shoqeria ka te drejte te hape filiale te saj ose agjenci ne qytetet e tjera te Republikes se Shqiperise ose jashte saj,ne perputhje me rregullat e shtetit perkates.

NENI 3

Shoqeria do te ushtroje veprimtarine e saj deri ne vitin 2050 e lart.Kjo periudhe kohe mund te zgjatet me vendim unanim te ortakeve .Shoqeria mund te mbylle veprimtarine e saj ne cdo kohe edhe para afatit, por vetem kur te kete vendosur me 50 % te kapitalit prezent ose 50 + 1 % te votave.

KAPITULLI II

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

NENI 4

Shoqeria ka per objekt te veprimtarise :

- Eksport - Importin e mallrave te ndryshme industriale, bujqesore , ushqimore , mjekesore,etj si dhe shitjen e tyre me shumice e pakice.

- Tregtimin e drithrave,perimeve frutave,si dhe te gjitha llojet e tjera te produkteve ushqimore dhe perpunimin e tyre

- Tregtimin e pijeve alkolike ,freskuese, te ujit ,duhanit e cigareve si dhe prodhimin e perpunimin e tyre.

-Tregtimin, prodhimin e perpunimin e lekureve ,te tekstileve e konfeksioneve Tregtimin e artikujve mekanike ,te artikujve e pajisjeve elektrike ,telefonike, elektronike, te makinave e te pjeseve te kembimit te tyre,te makinave e te pajisjeve bujqesore,te materialeve te ndertimit,te pajisjeve hidrosanitare , te letres te kinkalerise per zyra,si dhe bimet mjekesore ,medikamente dhe te atyre detare ( peshkimin).

- Tregtimin e lendeve te para ,te materialeve djegsore dhe perpunimin e tyre.Tregtimin e naftes dhe te derivateve te saj.Tregtimin e artikujve farmaceutike,te kozmetikes si dhe prodhimin e tyre.Tregtimin dhe prodhimin e artikujve te ndryshem kimike,si dhe te bojrave te llojeve te ndryshme per lyerje.

- Ushtrimin e veprimtarise ne fushen e turizmit,te hotelerise e restoranteve ,ne fushen e ndertimit ,financiare e bankare ,hapjen e nje banke private,te shoqerive te sigurimit,ne fushen e telekomunikacionit e informatikes,ne fushen e te gjitha llojeve te transportit,te marketingut,te lojrave te fatit e te kazinove ,ne fushen doganore,ne fushen mjekesore, ndertim spitale,krijimin e policive private per ruajtjen e objekteve ,si dhe ne cdo fushe tjeter te lejueshme ne Republiken e Shqiperise.

KAPITULLI III

KAPITALI THEMELOR

NENI 5

Kapitali themelor i shoqerise caktohet 100.000 ( njeqindmije ) leke.Kapitali themeltar ndahet ne 100 ( njeqind ) kuota me vlere nominale 1000( njemije ) leke , te emertuara 1 deri ne 100 ( njeqind ) .

Palet ortake do te kontribuojne ne themeltar te shoqerise si vijon :

1- Clement Israel 25.000 leke

2- David Fernandes 25.000 leke

3- Daniel Israel 25.000 leke

4- Irfan Hysenbelliu 25.000 leke

Perkatesisht secilës pale i takojne nga 25 kuota te kapitalit themeltar te shoqerise.

NENI 6

Kuotat e kapitalit themeltar jane te transferueshme ne rruge trashegimie edhe tek personat e trete.Para se kuotat e kapitalit themeltar t'u transferohen personave te trete , ato duhet t'u ofrohen ortakeve te shoqerise se vete te cilet kane te drejten e parablerjes, sipas rregullave te percaktuara ne nenin 47 te ligjit " Per shoqerite tregtare ".

NENI 7

Shoqeria njeh vetem ata ortake qe rezultojne ne librin e ortakeve .

NENI 8

Derdhjet e shumave te kapitalit per depozitim,palet ortake detyrohen t'i bejne ne proporcion me kuotat e percaktuara te kapitalit themeltar qe ka secili ne perputhje me kerkesat e ligjit.

NENI 9

Secili ortak ka te drejten e nje vote per cdo kuote prej 1000 leke qe ai ka ne kapitalin themeltar te shoqerise.

## K A P I T U L L I   IV

## ASAMBLEA  E  ORTAKEVE

### N E N I - 10

Asamblea e ortakeve thirret nga Presidenti,Administratoret ose nga eksperti kontabel i autorizuar nese ka te tille. Njoftimi per mbledhjen e asamblese behet 15 dita para dates se caktuar per zhvillimin e saj. Ortaket lajmerohen me leter rekomande ose fax ne te cilen njoftohen datat e ceshtjet e rendit te dites,vendi,ditet e zhvillimit te mbledhjes si dhe dita e mbylljes se saj.Secila mbledhje asambleje e thirrur ne menyre te parregullt mund te anullohet,megjithate anullimi nuk ka vlere ne rast se te gjithe ortaket jane te pranishem ose te perfaqesuar.

### N E N I - 11

Asamblea eshte e zakonshme dhe e jashtezakonshme.Asamblea e zakonshme duhet te thirret te pakten nje here ne vit brenda kater muajve nga mbyllja e ushtrimit te veprimtarise financiare te shoqerise. Per arsye te vecanta asamblea e zakonshme mund te thirret brenda gjashte muajve nga mbyllja e ushtrimit te veprimtarise financiare vjetore te shoqerise.

Asamblea e jashtezakonshme thirret per te ushtruar kompetencat e saj kur Presidenti dhe Administratoret e gjykojne te nevojshme,si dhe ne rastet e parashikuara ne ligj.Njoftimi per thirrjen e mbledhjes duhet te behet ne perputhje me rregullat e caktuara ne kete statut dhe me kerkesat e ligjit.

### N E N I - 12

Ne mbledhjen e Asamblese se Ortakeve kane te drejte te marrin pjese te gjithe ortaket te cilet rezultojne te rregjistruar ne librin e ortakeve,te pakten 8 dite para dates se caktuar ne mbledhjen e asamblese.

### N E N I - 13

Asamblea e ortakeve kryesohet nga kryetari i saj qe zgjidhet ne mbledhjen e asamblese.Ajo emeron edhe nje sekretar i cili mund te mos jete nga radhet e ortakeve te shoqerise.

## N E N I 14

Asambleja e zakonshme ose e jashtezakonshme mund te thirret nga nje ose disa ortake qe perfaqesojne te pakten 10 % te kuotave te kapitalit themeltar.

## N E N I 15

Vendimet e Asamblese se Ortakeve te marra konform me ligjin, kete statut dhe kontraten e themelimit jane te detyrueshme edhe per ortaket qe nuk kane qene te pranishem.

## N E N I 16

Asambleja e ortakeve ka ne kompetence te vendose per te gjitha ceshtjet qe ajo i quan te rendesishme dhe te nevojshme per mbarevajtjen e veprimtarise se shoqerise. Ajo percakton masen e pages e te shperblimit mujor te punonjesve te administrates dhe te punonjesve te tjere te shoqerise.

Per ceshtjet qe shqyrton ajo merr vendim me jo me pak se 50 % te kapitalit present ose 50 + 1 % te votave.

Kundershtimet eventuale ndaj vendimeve te Asamblese se Ortakeve mund te paraqiten per shqyrtim sipas dispozitave perkatese ligjore. Vendimet e Asamblese se Ortakeve duhet te jene te nenshkruara nga Kryetari i Asamblese dhe sekretari i saj.

## K A P I T U L L I V

## ADMINISTRATORI

## N E N I 17

Shoqeria mund te administrohet nga nje ose disa administratore te cilet mund te zgjidhen ( ose jo ) nga radhet e ortakeve te saj. Administratoret emerohen per here te pare qe me aktin e themelimit te shoqerise dhe me pas me perfundimin e afatit te percaktuar ata mund te rizgjidhet nga Asambleja e Ortakeve me 50 % te kapitalit present ose 50 + 1 % te votave.

Asambleja e Ortakeve vendos per numrin e administratoreve qe do te drejtojne shoqerine. Administratoret edhe pse jane te zgjedhur, mund te heqin dore nga detyra duke i njoftuar me shkrim ortaket 2 muaj perpara dates se largimit te tyre. Administratoret shkarkohen me 50 % te kapitalit present ose me 50 + 1 % te votave.

## N E N I 18

Kur Asamblea e Ortakeve vendos qe shoqeria te administrohet me dy administrator,ajo i pajis ata me te gjitha kompetencat e nevojshme qe te ushtrojne rregullisht detyren e tyre.Ata kane te drejte te kryejne te gjitha veprimet qe nuk i jane te ndaluara dhe qe konsiderohen te nevojshme per zhvillimin e shoqerise.Ata duke qene perfaqesues te shoqerise kane te drejte te hyjne ne marredhenie kontraktore me persona juridike ose fizike,mund te krijojne lidhje me shoqeri tregtare shqiptare ose te huaja te kryejne veprime depozitimi kreditimi,pagese ose arketimi,prane institucioneve bankare e financiare,si dhe te kryeje cdo lloj veprimtarie ne dobi te shoqerise e ne perputhje me objektin e saj te veprimtarise te percaktuar ne statut e ne aktin e themelimit.

## N E N I 19

Presidenti perfaqeson shoqerine ne te tretet .Ai ka te drejte te perfaqesoje shoqerine edhe ne organet gjyqesore si dhe ne te gjitha llojet e tjera te organeve shteterore ,per mbrojtjen e interesave te shoqerise .

## N E N I 20

Presidenti per te rritur pergjegjesine e tij ne kryerjen e detyres i jepet kompetenca qe te pranoje e te pushoje nga puna punetoret e nepunesit e shoqerise ne perputhje me rregullat ligjore ne fuqi.Ai ka te drejte te propozoje e t'i paraqise per miratim Asamblese se Ortakeve emerimin e drejtoreve dhe caktimin e kompetencave te tyre.

# K A P I T U L L I VI

## EKSPERTET KONTABEL TE AUTORIZUAR

## N E N I 21

Asamblea e Ortakeve mund te emeroje nje ose disa eksperte kontabel te autorizuar,ne zbatim te kerkesave te percaktuara ne nenin 59 te ligjit " Per shoqerite tregtare " ,per kontrollimin e garantimin e rregullsise te llogarive vjetore te shoqerise

## KAPITULLI VII

## BILANCI PER TE ARDHURAT

### NENI 22

Ushtrimi i vitit financiar te shoqerise fillon me 1 janar dhe mbyllet me 31 dhjetor te cdo viti.

### NENI 23

Raporti i presidentit se bashku me bilancin depozitohen ne seline e shoqerise 15 dite perpara dates se caktuar per mbledhjen e Asamblese se Ortakeve , ne menyre qe Ortaket te njihen me permbajtjen e tyre.

### NENI 24

Fitimi qe mbetet ne fund te vitit financiar pas zbritjes se fondit rezerve ose te fondeve te tjera,te detyrimeve fiskale e te shpenzimeve u ndahet palave ortake ne proporcion me kuotat e tyre ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Pjesa e fitimit qe i perket ortakeve te huaj te shoqerise mund te transferohet lirisht jashte Shqiperise.

## KAPITULLI VIII

## KONTROLLI I ORTAKEVE

### NENI 25

Secili ortak ka te drejte te kerkoje informacion prej presidentit per ecurine e punes se shoqerise dhe te konsultohet me librin dhe dokumentat e shoqerise.

Ortaku ka te drejte qe te marre ne cdo kohe raportin e presidentit ,inventarei dhe llogarite vjetore te shoqerise , per tre vitet e fundit financiare.Ai mund te ndihmohet nga nje ekspert i zgjedhur prej tij,i cili i nenshtrohet detyrimit per ruajtjen e sekretit profesional.

## K A P I T U L L I IX

## PRISHJA E SHOQERISE

### N E N I 26

Asamblea e Ortakeve kur shoqeria prishet emeron nje ose disa likuidatore per kryerjen e formaliteteve te likujdimit duke percaktuar edhe kompetencat dhe fuqite e tyre.

## K A P I T U L L I X

## ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE

### N E N I 27

Te gjitha mosmarreveshjet eventuale midis shoqerise dhe ortakeve , presidentit, administratoreve dhe likuidatoreve do te zgjidhen nga gjykata e rrethit Tirane. Megjithate para se keto mosmarreveshje t'i kalojne per shqyrtim gjykates,me deshiren e paleve ,ato mund te zgjidhen nga nje arbiter,i cili do te caktohet prej tyre me marreveshje te perbashket.

Secila pale qe nuk do te jete dakort me vendimin e arbitrit ,ka te drejte qe perfundimisht t'i drejtohet gjykates se rrethit te Tiranes, per zgjidhjen e ceshtjes.

## K A P I T U L L I XI

## DISPOZITA TE PERGJITHSHME

### N E N I 28

Per sa nuk eshte parashikuar ose shprehur ne dispozitat e ketij statuti ,referimi do te behet ne legjislacionin ne fuqi ne Republiken e Shqiperise.

### N E N I 29

Ortaket e shoqerise si persona fizike ose juridike duhet qe cdo bisnes qe do te kryejne ne Shqiperi ose nga jashte per Shqiperine do ta kryejne vetem nepermjet shoqerise.

Kjo do te thote : secili prej ortakeve te huaj te kesaj shoqerie si person fizik ose juridik nese do te beje biznes per ne Shqiperi me persona fizike ose juridike shqiptare ose te huaj ,biznesin detyrimisht do ta beje nepermjet kesaj shoqerie.Gjithashtu ortaku shqiptar nese do te beje biznes per Shqiperine me persona fizike ose juridike shqiptare ose te huaj, biznesin detyrimisht do ta beje nepermjet kesaj shoqerie.

NENI 30

Kjo kontrate hartohet ne shqip dhe ne frengjisht dhe kane te njejten vlere.Ajo behet ne pese kopje dhe firmoset rregullisht nga palet sot ne daten 20.09.1995 ne Tirane.

PALET ORTAKE

Seif. me prok. dt. 13.09.1995

Clement Israel

David Fernandes

Irfan Hysenbelliu

Daniel Israel

Perkthyese :
Elida Kalindi

# A K T I  I  T H E M E L I M I T

## K O N T R A T E

## P E R

## THEMELIMIN E SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR ME EMRIN " A L B E C O R P " I.B.O.

Kjo kontrate per themelimin e nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar ( sh.p.k.) e cila me poshte do te quhet " Kontrata " lidhet ndermjet paleve :

1 - Clement Israel  Nr.pasaportes 167778 A
datelindja 18.06.1939
vendlindja : Zaire AFRIKE
vendbanimi : 105 AV FRANKLIN , ROOSEVELT 1050 BRUXELLES BELGIQUE

2 - David Fernandes  Nr.pasaportes 5366762
datelindja 02.02.1943
vendlindja Zaire AFRIKE
vendbanimi 143 AV. ITALIE, BRUXELLES 1050, BELGIQUE

3 - Daniel Israel  Nr.pasaportes 0637201
datelindja 18.02.1969
vendlindja Zaire AFRIKE
vendbanimi : 105 AV FRANKLIN ROOSEVELT 1050 , BRUXELLES BELGIQUE

4 - Irfan Hysenbelliu  Nr.pasaportes 0026848
datelindja 08.04.1959
vendlindja Skrapar
vendbanimi : Rr.Sami Frasheri,Pallati 13,Ap16 Tirane, SHQIPERI

Ortaket e shoqerise te cilet ne kete kontrate per lehtesi do te quhen " Pale " me lidhjen e kesaj kontrate kane per qellim te themelojne nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar ( Sh.p.k.) e cila me poshte do te quhet " Shoqeria ".
Palet ne kete kontrate rane dakort per sa me poshte vijon :

### N E N I 1

Palet me anen e kesaj kontrate themelojne nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar ( Sh.p.k.) e cila emertohet " ALBECORP " I.B.O.

## N E N I 2

Ne perputhje me legjislacionin shqiptar,shoqeria eshte person juridik dhe veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave te kesaj kontrate , statutit te saj,sipas ligjit " Per shoqerite tregtare " si dhe te akteve te tjera ligjore.

Statuti i shoqerise i bashkelidhet kesaj kontrate dhe eshte pjese e pandare e perberese e saj.

## N E N I 3

Shoqeria ka per objekt te veprimtarise :

- Eksport - Importin e mallrave te ndryshme industriale, bujqesore , ushqimore mjekesore,etjsi dhe shitjen etyre me shumice e pakice.

Tregtimin e drithrave,perimeve frutave,si dhe te gjitha llojet e tjera te produkteve ushqimore dhe perpunimin e tyre.

- Tregtimin e pijeve alkolike freskuese, te ujit ,duhanit e cigareve si dhe prodhimin e perpunimin e tyre.

-Tregtimin, prodhimin e perpunimin e lekureve ,te tekstileve e konfeksioneve. Tregtimin e artikujve mekanike ,te artikujve e pajisjeve elektrike, telefonike, elektronike, te makinave e te pjeseve te kembimit te tyre,te makinave e te pajisjeve bujqesore te materialeve te ndertimit,te pajisjeve hidrosanitare te letres te kinkalerise per zyra,si dhe bimet mjekesore ,medikamente dhe te atyre detare ( peshkimin).

Tregtimin e lendeve te para ,te materialeve drusoredhe perpunimin e tyre. Tregtimin e naftesdhe te derivateve te saj.Tregtimin e artikujve farmaceutike,te kozmetikes si dhe prodhimin e tyre.Tregtimin dhe prodhimin e artikujve te ndryshem kimike si dhe te bojrave te llojeve te ndryshme per lyerje.

Ushtrimin e veprimtarise ne fushen e turizmit te hotelerise e restoranteve ,ne fushen e ndertimit ,financiare e bankare ,hapjen e nje banke private,te shoqerive te sigurimit,ne fushen e telekomunikacionit e informatikes,ne fushen e te gjitha llojeve te transportit,te marketingut,te lojrave te fatit e te kazinove ,ne fushen doganore,ne fushen mjekesore, ndertim spitale,krijimin e policive private per ruajtjen e objekteve ,si dhe ne cdo fushe tjeter te lejueshme ne Republiken e Shqiperise.

## N E N I 4

Selia e shoqerise eshte ne Rrugen "Sami Frasheri " Pallati 13, Apartamenti 16 Tirane.

## N E N I 5

Emri , selia dhe objekti i veprimtarise se shoqerise mund te ndryshojne vetem me 50 % te kapitalit prezent plus 1 % te votave.

NENI 6

Shoqeria do te filloje veprimtarine e saj , nga data e regjistrimit ne regjistrin tregtar ne gjykaten e rrethit Tirane si person juridik dhe do te vazhdoje deri ne fund te vitit 2050.

NENI 7

Shoqeria ka vulen perkatese me elementet e saj qe do miratohet nga palet ortake ne kete kontrate.

NENI 8

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 leke. Kapitali ndahet ne 100 kuota me vleren 1000 ( njemije ) leke secila te emertuara 1 deri ne 100.

Palet qe do te kontribuojne ne kapitalin themeltar :

1. Element Israel 25 %
2. David Fernandes 25 %
3. Daniel Israel 25 %
4. Irfan Hysenbelliu 25 %

NENI 9

Palet pjesen e tyre te kapitalit themeltar do e derdhin ne para sipas rregullave te caktuara ne statutin e shoqerise. Veprimet e depozitimit ne banke ose ne noteri te kapitali themeltar do te behen nga Irfan Hysenbelliu.

NENI 10

Rritja e kapitalit themeltar fillestar te shoqerise mund te behet vetem ne masen e ruajtjes se raporteve qe ka secila pale ne kete kapital.

NENI 11

Shoqeria lejohet te hyje ne marredhenie bashkepunimi me persona te tjere juridike e fizike. Ajo ka te drejte te krijoje edhe shoqeri te perbashketa ose te marre pjese ne shoqeri te tilla.

NENI 12

Palet ortake ne kete shoqeri nuk pergjigjen per detyrimet e shoqerise qe rrjedhin nga objekti i veprimtarise se saj, tej kapitalit themeltar ne te cilen ata kane marre pjese. Po keshtu edhe shoqeria nuk pergjigjet per detyrimet personale te paleve ortake ne kete shoqeri.

NENI 13

Shoqeria do te drejtohet nga keto organe : 1. Asambleja e Ortakeve, 2. Administratoret, 3. Eksperet kontabel te autorizuar.

NENI 14

Organi vendimor i shoqerise eshte Asambleja e ortakeve e cila perbehet nga palet ortake ne kete kontrate themelimi, rregullat per veprimtarine e shoqerise dhe Asamblene e Ortakeve percaktohen ne statutin e shoqerise qe i bashkelidhet kesaj kontrate.

NENI 15

Organi administrativ i shoqerise jane Administratoret. Palet qe ne themelimin e shoqerise kane dakord qe Administratoret te jene :
1 - Irfan Hysenbelliu
2 - Daniel Israel

Zoti Irfan Hysenbelliu emerohet President i Shoqerise "ALBCORP" F.B.O.

## N E N I 16

Palet mund te caktojne eksperte kontabel te autorizuar ne mbledhjen e pare te asamblese se ortakeve ,pas rregjistrimit te shoqerise ose edhe me vone.Ne keto mbledhje do te vendoset per numurin e eksperteve te cilet do te jene ekonomiste ose juriste.

## N E N I 17

Fitimi i shoqerise do te ndahet si vijon :

Clement Israel 25 %
David Fernandes 25 %
Daniel Israel 25 %
Irfan Hysenbelliu 25 %

## N E N I 18

Ne vendin qe do te percaktojne palet do te mbahen te plota dhe te sakta libra llogarie ne te cilat do te pasqyrohet gjendja e biznesit si dhe financat e shoqerise.Do te mbahen gjithashtu libri i ortakeve e i gjithe dokumentacioni i nevojshem i shoqerise. Secila nga palet ka te drejte te ushtroje kontroll ne keto libra e dokumenta .

## N E N I 19

Per kryerjen e veprimtarise se saj shoqeria do te cele llogari bankare

## N E N I 20

Shoqeria prishet me mbarimin e afatit te parashikuar ne kete kontrate,ne rast se palet nuk e perseritin ate ,ose per shkaqe te ligjshme.

## N E N I 21

Kur shoqeria prishet nis procedura e likujdimit te saj.Likujduesit caktohen nga palet dhe veprojne ne perputhje me kerkesat e ligjit me nenet 264,275 te ligjit " Per shoqerite tregtare"

## N E N I 22

Kur shoqeria likujdohet ,likujduesi i paraqet Asamblese se Ortakeve bilancin e likujdimit.Shoqeria i jep fund veprimtarise se saj ne castin e miratimit te bilancit te likujdimit.Mjetet financiare dhe cdo pasuri tjeter qe shoqeria do te kete kur ajo te likujdohet ndahet midis ortakeve ne kete kontrate, ne perputhje me kuotat qe ata kane ne kapitalin themeltar pasi te jene bere pagesat ndermjet kreditoreve.

## N E N I 23

Mosmarreveshjet midis shoqerise dhe ortakeve do te zgjidhen nga gjykata e rrethit Tirane pasi me pare te jete zbatuar procedura e parashikuar ne statutin e shoqerise.

## N E N I 24

Ortaket e shoqerise si persona fizike ose juridike duhet qe cdo biznes qe do te kryejne ne Shqiperi ose nga jashte per Shqiperine do ta kryejne vetem nepermjet shoqerise.

Kjo do te thote : secili prej ortakeve te huaj te kesaj shoqerie si person fizik ose juridik nese do te beje biznes per ne Shqiperi me persona fizike ose juridike shqiptare ose te huaj ,biznesin detyrimisht do ta beje nepermjet kesaj shoqerie.Gjithashtu ortaku shqiptar nese do te beje biznes per Shqiperine me persona fizike ose juridike ,shqiptare ose te huaj biznesin detyrimisht do ta beje nepermjet kesaj shoqerie.

## N E N I 25

Kjo kontrate hartohet ne shqip dhe ne frengjisht dhe kane te njejten vlere.Ajo behet ne pese kopje dhe firmoset rregullisht nga palet sot ne daten 20.09.95 ne Tirane.

PALET ORTAKE

[illegible] me Prev. dt. 13.09.1995

Klement Israel

David Fernandes

Përkthyese: Elida Malindi

Irfan Hysenbelliu

Daniel Israel